



# UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

## SENATI

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më: 22.05.2026

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 42 dhe nenit 47 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. prot. 04-V-621, datë 30 maj 2013, dhe duke vendosur lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. 01-06, datë 06.01.2025, Senati në mbledhjen e mbajtur më datë 22.05.2026, mori këtë:

### V E N D I M

*për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren me nr. 01-06, të datës 06.01.2025*

- I. Plotësohet – ndryshohet Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren me nr. 01-06, të datës 06.01.2025 si në vijim:

- Shtohet një dispozitë e re me këtë përmbajtje:

Bazuar në Rregulloren për Kërkime Shkencore, Komisioni i Studimeve në nivel të Universitetit e shqyrton, verifikon dhe e vlerëson përputhshmërinë e të arriturave kërkimore – shkencore të personelit akademik me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit, në përputhje me kriteret e kësaj Rregulloreje.

- Riformulohet dispozita përkatëse si vijon:

Kundër vendimit të Senatit mund të paraqitet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashpresa brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i vendimit. Komisioni i paraqet Senatit propozimin përkatës, ndërsa Senati, pas shqyrtimit të tij, merr vendim përfundimtar në procedurë administrative brenda Universitetit, ndaj të cilit mund të iniciohet kontest pune në gjykatën kompetente, në përputhje me Ligjin e Punës.

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### Vendimi t'i dërgohet:

- Menaxhmentit;
- Personelit akademik;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Senatit;
- Arkivit.

Kryesues i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani

